**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**
**T I R A N Ë**
**Nr.24688/12 VENDIMI**

# V E N D I M
# I GJYQTARIT TË VETËM

Unë, Gjyqtare e Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, A. Zumbardhu (Coco), sot më datë 11.07.2006, pasi studiova kërkesën e paraqitur nga Drejtori i Shoqërisë Tregtare "Ujësjellës-Kanalizime" SHA Sarandë z. Kristaq KALI përfaqësuar me Autorizimin dt.15.05.2006 nga av. Petrit Petriti, i cili kërkon depozitim pranë Regjistrit Tregtar të Urdhërave Nr. 182, dt. 06.03.2006 dhe Nr. 247, dt. 04.04.2006 të Ministrit Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës "Për ndryshim në Këshillin Mbikqyrës" të Shoqërisë Tregtare "Ujësjellës-Kanalizime" SHA Sarandë dhe Vendimit Nr. 2, dt.19.05.2006 të Këshillit Mbikqyrës;

## K O N S T A T O V A

Shoqëria Tregtare "Ujësjellës-Kanalizime" SHA Sarandë, tërësisht me kapital shtetëror, është regjistruar si person juridik pranë Regjistrit Tregtar, me Vendimin Nr. 24688, datë 27.10.2000 të Gjykatës Rrethit Tiranë.
Aksioneri shtet, i përfaqësuar nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, bazuar në Ligjin nr. 7638, dt. 19.11.1992, Ligjin nr. 7926, dt. 20.04.1995 i ndryshuar si dhe në V.K.M. Nr. 642, dt. 11.10.2005 "Për Këshillat Mbikqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore";

**A)** Me Urdhërin Nr. 182 dt.06.03.2006 ka vendosur:

**1.** Lirimin nga detyra të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të "Ujësjellës - Kanalizimeve" SHA Sarandë: znj. Sonila MALKO, z. Malo HIZDRI dhe znj. Rajmonda GJONI

**2.** Emërimin si anëtarë të Këshillin Mbikqyrës të "Ujësjellës - Kanalizimeve" SHA Sarandë: znj. Ludvidha GUGUSHKA, z. Bujar LEKA dhe z. Robert MAÇI

**B)** Me Urdhërin Nr. 247 dt. 04.04.2006 ka vendosur:

1. Lirimin nga detyra e anëtarit të Këshillit Mbikqyrës të "Ujësjellës - Kanalizimeve" SHA Sarandë të znj. Ludvidha GUGUSHKA
2. Emërimin anëtar në Këshillin Mbikqyrës të "Ujësjellës - Kanalizimeve"SHA Sarandë të z. Kreshnik BOZHO.

Aktualisht Anëtarë të Këshillit Mbikqyrës janë:

1. z. Kreshnik BOZHO
2. z. Robert MAÇI
3. z. Bujar LEKA

**C)** Këshilli Mbikqyrës me Vendimin Nr. 2, dt. 19.05.2006 ka vendosur:

1. Zgjedhjen Kryetar të këshillit Mbikqyrës **z. Kreshnik BOZHO**
2. Rikonfirmimin Drejtor të shoqërisë **z. Kristaq KALI**

Mbështetur në Urdhërat Nr.182, dt. 06.03.2006 dhe Nr.247, dt. 04.04.2006 të Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës "Për ndryshim në Këshillin Mbikqyrës" dhe në Vendimin e Këshillit Mb9ikqyrës, të cilët i plotësojnë kushtet e parashikuara nga legjislacioni tregtar, kërkesa është e drejtë, e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në ligjin Nr. 7632 dt.04.11.1992; Ligjin Nr. 7638 dt.19.11.1992 dhe ne Ligjin Nr. 7667 dt. 28.01.1993

## V E N D O S A

- Pranimin e kërkesës.
- Depozitimin e Urdhërit Nr.182, dt. 06.03.2006 të Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës "Për ndryshim në Këshillin Mbikqyrës" për lirimin nga detyra të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të "Ujësjellës - Kanalizimeve" Sarandë: znj. Sonila MALKO, z. Malo HIZDRI dhe znj. Rajmonda GJONI, duke u emëruar anëtar në Këshillin Mbikqyrës të "Ujësjellës - Kanalizimeve"SH.A. Sarandë: znj. Ludvidha GUGUSHKA, z. Bujar LEKA dhe z. Robert MAÇI.
- Depozitimin e Urdhërit Nr. 247, dt. 04.04.2006 të Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës "Për ndryshim në Këshillin Mbikqyrës" për lirimin nga detyra të anëtarit të Këshillit Mbikqyrës të "Ujsjellës - Kanalizimeve" Sarandë: znj. Ludvidha GUGUSHKA, duke emëruar anëtar në Këshillin Mbikqyrës të "Ujësjellës - Kanalizimeve"SH.A. Sarandë: z. Kreshnik BOZHO.
- Depozitimin e vendimit Nr. 2, dt. 19.05.2006 të Këshillit Mbikqyrës për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit Mbikqyrës **z. Kreshnik BOZHO** dhe rikonfirmimin e Drejtorit të shoqërisë **z. Kristaq KALI.**
- Urdhërohet Zyra e Rregjistrit Tregtar të bëjë shënimet përkatëse në Rregjistrin Tregtar.
- Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit.

**GJYQTARE**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**Shoqëria Tregtare "Ujësjellës Kanalizime" SHA**
**SARANDË**

NOTER TIRANË

# VENDIM Nr. 2
# I
# KËSHILLIT MBIKQYRËS
**Shoqëria Tregtare "Ujësjellës Kanalizime" SHA**
**SARANDË**

Këshilli Mbikqyrës i mbledhur sot më datë 19.05.2006 në selinë e shoqërisë mori në shqyrtim këtë rend dite:

1. Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit Mbikqyrës
2. Zgjedhja e Drejtorit të shoqërisë

Pasi diskutoi kandidaturat me unanimitet,

## VENDOSI

1. Zgjedhjen si Kryetar të Këshillit Mbikqyrës **z. Kreshnik BOZHO**
2. Rikonfirmimin si Drejtor të shoqërisë **z. Kristaq KALI**

Ngarkohet Drejtori i shoqërisë z. Kristaq Kali të kryejë të gjitha procedurat për depozitimin e akteve të shoqërisë pranë Regjistrit Tregtar Tiranë.

**Këshilli Mbikqyrës**

**Kreshnik BOZHO** | **Buja LEKA** | **Robert MAÇi**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**SHOQERIA TREGETARE "UJESJELLES KANALIZIME" SH.A**
**SARANDE**

---

# V E N D I M

**I**

**KESHILLIT MBIKQYRES**

**Shoqeria Tregtare "Ujesjelles Kanalizime" SHA**

**S A R A N D E**

Keshilli Mbikqyres i mbledhur sot me date 28.08.2007 ne selin e shoqerise mori ne shqyrtim kete rend dite:

1. Lirimin nga detyra te Drejtorit Ekzekutiv te kesaj sh.a-je.
2. Emerimin e Drejtorit te ri Ekzekutiv te sh.a Ujesjelles Kanalizime Sarande.

Pasi diskutoi kandidaturat me unanimitet,

**V E N D O S I**

1. Lirimin nga detyra e Drejtorit Ekzekutiv te kesaj sh.a z.Kristaq KALI.
2. Emerimin e Drejtorit te ri Ekzekutiv te kesaj sh.a-je z.Qesko ÇAKALLI.

**KESHILLI MBIKQYRES**

**Kreshnik BOZHO** **Besa SHAHINI** **Robert MAÇI**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**SHOQËRIA "" UJESJELLES KANALIZIME " SH.A**

**SARANDE**

**NIPT J64228814D**

**VENDIM I KESHILLIT MBIKQYRES**

**Nr 3 Date 30./10./...2012**

Keshilli mbikqyres u njof me shkresen nr ___ date ____ te Kryetarit te Asamblese,I cili I bene me dije se Zoti Durim Bajo ka dhene doreheqen si anetar I Keshillit Mbikqyres.

Keshilli Mbikqyres i ''UKS'' sha Sarande, ne zbatim te Ligjit nr.9901 date 14.04.2008, **Neni 158,167dhe nenit 230 pika 2,si dhe**

VKM nr.642 date 11.10.2005
VKM nr.677 date 03.10.2007
VKM nr.678 date 03.10.2007
Udhezimi METE nr.965 date 11.12.2007

,dhe ne mbeshtetje te nenit 22,pika 1,dhe nenit 24,pika 3, te statutit te shoqerise;

**VENDOSI:**

1.Te emeroj zotin Durim Bajo,me profesionin ing.Hodroteknik,si Administrator te Shoqerise :" Ujesjelles Kanalizime " SH.A. Sarande, me mandat 3--(tre) vjecar.me kontrate te rinovueshme per cdo vit kalendarik.

3.Autorizohet z. Irena Marjani, qe te depozitoj kete vendim,shkresen nr ___ date____ te Kryetarit te Asamblese si dhe Deklaraten e zotit Durim Bajo ne Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKR).

KESHILLI MBIKQYRES UJESJELLES KANALIZIME SHA SARANDE

z.Rustem Duka—Bashkia Sarande.................
z.Saimir Barjamaj—Bashkia Sarande.................
z.Krenar Bedaj---Bashkia Sarande.................
z.Kristo Kaishi---Komuna Aliko.................
z.Themistokli Kaishi---Komuna Mesopotam.........
z.Albert Jorgji-----Bashkia Sarande.................

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**SHOQERIA "UJESJELLES - KANALIZIME" SH. A**
**ASAMBLEJA E PERGJITHSME E AKSIONEREVE**
**S A R A N D E**

---

**VENDIM**
**I ASAMBLESË SË PËRGJITHËSHME**
**TË SHOQËRISË UJËSJELLËS - KANALIZIME Sh.a SARANDË**

**Nr. 1, datë 28/02/2019**

Bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 « Për Shoqëritë tregetare », i ndryshuar, në Ligjin Nr. 139/2015 për « Vetëqeverisjen Vendore », V.K.M. Nr. 63 datë 27.01.2016 « Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura », V.K.M nr. 642 dat 11.10.2005, neni 6, pika c « Për Këshillat Mbikqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore »,

Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve të Shoqërisë "Ujësjellës - Kanalizime" sh.a Sarandë, e përbërë nga :

- Bashkia Sarandë përfaqësuar nga Kryetare znj. Florjana Koka.

**V E N D O S I** :

1.Lirimin nga detyra të anëtarit të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime sh.a Sarandë, Z.Ari Lango, bazuar në kërkesën e tij për dorëheqje.

2.Emërimin si anëtar të Këshillit të Administrimit, Z.Durim Bajo.

Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime sha Sarandë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHËSHME E AKSIONERËVE**

**BASHKIA SARANDË**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**SHOQERIA "UJESJELLES - KANALIZIME" SH. A**
**ASAMBLEJA E PERGJITHSME E AKSIONEREVE**
**S A R A N D E**

---

**VENDIM**
**I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME**
**TE SHOQERISE UJESJELLES - KANALIZIME Sh.a SARANDE**
**Nr. 1, date 04/11/2019**

Bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 **« Për shoqëritë tregetare »,** i ndryshuar, në Ligjin Nr. 139/2015 për **« Vetqeverisjen Vendore »** Neni 64, pika « f « , V.K.M. Nr. 63 datë 27.01.2016 **« Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave te ndotura » ,**

Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve te Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime sh.a Sarandë, e perbere nga :

- Bashkia Sarande përfaqesuar nga Kryetari Z. Adrian Gurma.

**V E N D O S I** :

1.Miratimin e Këshillit të Administrimit të Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Sh.A Sarandë, me mandat 3-vjecar, me këtë përbërje :

a)Sheme Lulo
b)Eleron Gjoni
c)Kristaq Kali

2.Miratimin e Administratorit të Shoqërisë Z.Sheme Lulo, me mandat 3-vjecar, me kontratë të rinovueshme cdo vit.

3. Pozicionin e sekretares se Asamblesë së Përgjithshme do të vazhdojë ta mbajë Znj. Anila Vjeri.

5.Depozitimin e këtij vendimi ne QKB.

Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime sha Sarandë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE**

**BASHKIA SARANDE**